

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6623
E martë, 7 qershor 2022
çmimi 0.40 €

Kërkohet që çështja e
Luginës së Preshevës
të trajtohet në OKB | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VETERANËT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (UÇK) KANË PROTESTUAR TË HËNËN PARA OBJEKTIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS NË SHENJË PAKËNAQËSIE PËR MOSPËRFSHIRJEN E TYRE NË RRRITJEN E PAGËS MINIMALE

VETERANËT E UÇK-së PARALAJMËROJNË PROTESTË MË TË ASHPËR DHE BLOKIM TË INSTITUCIONEVE | FAQE 4-5



Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, gjatë protestës ka thënë se kërkesat e veteranëve të UÇK-së janë injoruar nga institucionet e Kosovës dhe, sipas tij, janë të detyruar që pakënaqësitë

t'i shprehin në protestë. Ai ka thënë se kjo protestë ishte paralajmërim që herëve të tjera do t'i bllokojnë institucionet. "Nuk do t'i lëmë të hyjnë as brenda", ka thënë Klinaku

Vdes një person pas rrëzimit të një lisi në Prishtinë | FAQE 3



BRITANIA DO TË DËRGOJË RAKETA ME RREZE TË GJATË NË UKRAINË | FAQE 2



AKTUALE



KURTI UDHËTON PËR NË BRITANI TË MADHE | F. 3

PKD-JA KËRKON QË PAGA MINIMALE TË BËHET 350 EURO | F. 7

LIMAJ: KOMANDANT 'KAPUÇI' E DONTE LIRINË E KOSOVËS | F. 7

EKONOMI



KOSOVA MUND TË KETË RRRITJE TË PËRSHPEJTUAR EKONOMIKE DUKE SHTUAR RITMIN E REFORMAVE | F. 8

ATK-JA MBLODHI 35.6 MILIONË PËR PERIUdhËN JANAR - MAJ | F. 8

SPORT



SELMANI: PO LARGOHEM ME KOKËN LART NGA LLAPI | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania do të dërgojë raketa me rreze të gjatë në Ukrainë

LONDËR, 6 QERSHOR - Mbretëria e Bashkuar do t'i dërgojë raketat e para me rreze të gjatë në Ukrainë pavarësisht prej kërcënimeve të Rusisë për Perëndimin.

Ministri britanik i Mbrojtjes, Ben Wallace, ka thënë se disa sisteme raketore M270 do të dërgohen në Ukrainë në mënyrë që ky shtet të mbrohet nga Rusia.

Qeveria britanike nuk ka konfirmuar sa armë të tilla do të dërgohen, mirëpo transmetuesi britanik BBC ka marrë vesh që fillimisht do të nisen tri të tilla.

Ky vendim është marrë në koordinim me Shtetet e Bashkuara të cilat kanë njoftuar javën e kaluar se do të dërgojnë sisteme raketore në Ukrainë.

Veprimi i Shteteve të Bashkuara veçse ka zemëruar Moskën, pasi presidenti rus, Vladimir Putin, ka kërcënuar të dielën për

zgjerim të listës së shënjestrave që Rusia do të sulmojë në Ukrainë, nëse shtetet e Perëndimit do t'i dërgojnë Kievit armë me rreze të gjatë.

Qeveria britanike ka thënë se ushtria ukrainase do të trajnohet si t'i përdorë lansueset e raketave në javët në vazhdim.

Teksa ka bërë me dije vendimin, Wallace ka thënë se Mbretëria e Bashkuar është duke marrë rol udhëheqës për furnizim të trupave ukrainase me "armë të rëndësishme, të cilat janë të nevojshme për ta mbrojtur shtetin nga pushtimi i paprovokuar". "Teksa taktikat e Rusisë ndryshojnë, ashtu duhet të ndodhë me mbështetjen tonë në Ukrainë". "Këto sisteme raketore do t'u mundësojnë shokëve ukrainas ta mbrojnë veten më shumë kundër artilerisë së rëndë të cilën forcat e Putinit e përdorin pa dallim



nëpër qytete". Sistemet raketore britanike mund të nisin 12 raketa tokë-tokë

brenda një minute dhe mund të sulmojnë shënjestra brenda 80 kilometrave me precizitet të lartë.

Ky sistem është i ngjashëm me atë që dërgon ShBA-ja në Ukrainë, HIMARS.

Ambasadori amerikan në Rusi nuk pret përmirësim të raporteve



MOSKË, 6 QERSHOR - Ambasadori amerikan në Moskë, John Sullivan, tha se Uashingtoni dhe Moska ka pak gjasa që marrëdhëniet mes dy shteteve të bëhen më produktive "në një kohë të afërt".

Raportet mes dy shteteve janë përkeqësuar pothuajse në nivelin e pas Luftës së Ftohtë, qëkur Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt. Për shkak të luftës, ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian kanë vendosur disa raunde sanksionesh të ashpra ndaj Moskës.

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka thënë se pushtimi është pikë

kthese në historinë ruse: një revoltë kundër hegjemonisë së ShBA-së që Putini thotë se e ka poshtëruar Rusinë që prej shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik më 1991. "Hezitoh që të bëj parashikime se Rusia dhe ShBA-ja kurrë nuk do të kenë një marrëdhënie më produktive. Nuk mund të them se sa do të duhet për këtë. Në atmosferën aktuale, nuk do të ndodhë... Nuk do të ndodhë sa të jem unë gjallë", tha Sullivan në një intervistë për agjencinë e lajmeve TASS.

Ai shtoi se për "ShBA-në, presidenti [Joe] Biden e ka bërë të qartë pozicionin tonë: nuk do

të sillemi normalisht me Rusinë". Sullivan tha se raportet ShBA - Rusi kanë arritur nivelin më të ulët prej epokës pas Luftës së Ftohtë.

Sullivan u kthye në Moskë në qershor të vitit 2021 pasi ishte thirrur dy muaj më herët të kthehej në ShBA, pasi Rusia iu kundërpërgjigj Uashingtonit me sanksione dhe përjashtimin e diplomatëve.

Sullivan tha se, pavarësisht prej raporteve të përkeqësuar, Rusia nuk duhet ta mbyllë Ambasadën Amerikane në Moskë pasi, sipas tij, kanalet duhet të mbeten të hapura në mënyrë që dialogu të vazhdojë.

Lavrov: Anulimi i vizitës në Serbi, i pashembullt

MOSKË, 6 QERSHOR - Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka thënë të hënën se anulimi i vizitës së tij në Serbi ka qenë i pashembullt. Ai i ka bërë këto deklarata në një konferencë për medie, pasi vendet afër Serbisë - Bullgaria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi - kanë mbyllur hapësirat ajrore për aeroplanin që planifikohej ta dërgonte kryediplomatën rus të hënën në Beograd. "Nëse vizita e ministrit të Jashtëm rus në Serbi shihet nga Perëndimi si kërcënim në shkallë universale, atëherë gjërat në Perëndim janë qartazi shumë keq".

Lavrov ka thënë se homologu i tij serb, Nikolla Sellaković,

është ftuar në Moskë dhe shpreson që udhëtimi i tij nuk do të pengohet. "Gjëja kryesore është se askush nuk do të mund t'i shkatërrojë lidhjet tona me Serbinë".

Ministri i Brendshëm serb, Aleksandar Vullin, ka thënë se i vjen shumë keq për pengesën e vizitës së Lavrovit të cilin e ka përshkruar "mik të mrekullueshëm dhe të dëshmuar të Serbisë". "Një botë në të cilën diplomatët nuk mund të arrijnë paqe, është botë në të cilën nuk ka paqe. Ata që parandaluan arrijten e Sergei Lavrovit nuk duan paqe. Ata ëndërrojnë të mposhtin Rusinë", ka thënë Vullin. "Serbia është krenare që

nuk është pjesë e histerisë anti-ruse, ndërsa shtetet që janë pjesë do të kenë kohë për t'u turpëruar", ka pohuar ai.

Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, e ka konsideruar vendimin "një tjetër kanal të mbyllur të komunikimit".

Kremlini ka thënë të hënën se mbyllja e hapësirës ajrore ka qenë "veprim armiqësor". Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u ka thënë gazetarëve se një veprim i tillë mund ta ndryshojë orarin e takimeve të nivelit të lartë diplomatik. Megjithatë, Peskov ka thënë se kjo gjë nuk do ta pengojë Moskën për mbajtjen e kontakteve me shtetet mike.



Kurti udhëton për në Britani të Madhe

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar

për në Britani të Madhe. Gjatë qëndrimit atje kryeministri Kurti do të zhvillojë takime të nivelit të

lartë. Në mesin e tyre ai do të takohet me sekretaren britanike për Punë të Jashtme, Liz Truss.

Kurti do të mbajë një ligjëratë të hapur në Oxford Union dhe në Universitetin Cambridge.



Vdes një person pas rrëzimit të lisit në Prishtinë

xPrishtinë, 6 qershor - Një person ka vdekur të hënën pas rrëzimit të një lisi në Prishtinë, ka konfirmuar Policia e Kosovës. Ndërkaq, një grua, rreth të 30-tave, po ashtu është dërguar për trajtim mjekësor. "Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes dhe nga informatat e para janë ngritur dyshimet se një nga të lënduarit, mashkull, rreth 30 vjeç, ka humbur jetën, ndërsa e lënduara tjetër, femër, po ashtu rreth 30 vjeç, është dërguar në QKUK për trajtim të nevojshëm mjekësor", thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës.

Si pasojë e erërave të fuqishme janë rrëzuar disa drurë në Prishtinë. Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Alban Zogaj, u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i shmangin pjesët e qytetit që kanë drurë. "Ekipet tona të shpëtimit janë në terren dhe po merren me rastet e aksidenteve", ka shkruar ai në "Facebook".

Ndërkaq, policia ka njoftuar se po ndërmerren të gjitha veprimet për t'i sqaruar rrethanat e ngjarjes ku ka mbetur i vdekur një person.



Ministri Peci: Kosova përfiton nga përvoja e Iowas në bujqësi dhe blegtori

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Thellimi i bashkëpunimit të Kosovës me shtetin e Iowas do ta mundësojë ngritjen e kapaciteteve institucionale si dhe shkëmbimin e përvojave me ekspertë të sektorit të bujqësisë nga ky shtet, i cili njihet si një nga prodhuesit më të mëdhenj në Amerikë të shumë produkteve bujqësore, është shprehur ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, në hapjen e konferencës "Mundësitë për zhvillim të industrisë të bagëtive të qumështit në Ballkan dhe më gjerë", e cila është mbështetur nga MBPZHR-ja, Fondi Esminger i Universitetit Shtetëror të Iowas, Universiteti i Prishtinës, si dhe Asociacioni i Prodhuesve të Qumështit në Kosovë. "Ne kemi zyrtarizuar bashkëpunimin me Universitetin

e Iowas të Shkencës dhe Teknologjisë përmes një memorandumi bashkëpunimi, të nënshkruar vitin e kaluar, në mënyrë që t'i ngrehim kapacitetet tona dhe të shkëmbejmë përvoja me ekspertë të sektorit të bujqësisë. Krahas kësaj, është synim dhe interesim imi si ministër i Bujqësisë që të kontribuoj në ofrimin e mundësive për përafrimin akademik në mes të UP-së, respektivisht Fakultetit të Bujqësisë dhe Universitetit të Iowas të Shkencës dhe Teknologjisë me qëllim që studentët tanë të kenë qasje në programet që ky universitet ofron", ka theksuar ministri Peci. Ndër të tjera, ai ka falënderuar profesorin Curtis Youngs për kontributin e vazhdueshëm për sektorin e blegtorisë në Kosovë dhe të gjithë të pranishmëve në konferencë u ka uruar punë të mbarë.

Punimet në tunelin e Skërficës drejt përfundimit, për 45 minuta shkurtohet udhëtimi drejt Sarandës

TIRANË, 6 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se punimet në tunelin e

Skërficës janë drejt përfundimit, me të cilin hapet përfundimisht edhe rruga e re dhe e shumëpritur

Kardhiq - Delvinë. Rama në "Facebook" ka shkruar se kjo rrugë do të zbulojë një tjetër pjesë të mrekullueshme të

Shqipërisë, duke shkurrtuar njëkohësisht kohën e udhëtimit drejt Sarandës me 45 minuta.





VETERANËT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (UÇK) KANË PROTESTUAR TË HËNËN PARA OBJEKTIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS NË SHENJË PAKËNAQËSIE PËR MOSPËRFSHIRJEN E TYRE NË RITJEN E PAGËS MINIMALE

Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protestë më të ashpër dhe bllokim të institucioneve

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, gjatë protestës ka thënë se kërkesat e veteranëve të UÇK-së janë injoruar nga institucionet e Kosovës dhe, sipas tij, janë të detyruar që pakënaqësitë t'i shprehin në protestë. Ai ka thënë se kjo protestë ishte paralajmërim që herëve të tjera do t'i bllokojnë institucionet. "Nuk do t'i lëmë të hyjnë as brenda", ka thënë Klinaku

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë protestuar të hënën para objektit të Kuvendit të Kosovës në shenjë pakënaqësie për mospërfshirjen e tyre në rritjen e pagës minimale. Derisa ishin duke protestuar, disa nga protestuesit kishin hyrë në oborrin e Kuvendit. Para dyerve të këtij institucioni ka dalë Policia e Kosovës e cila ka përdorur sprej në drejtim të protestuesve. Sipas policisë, dy zyrtarë policorë janë lënduar në protesta dhe një qytetar ka kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të gazit lotsjellës në ato ambiente. Megjithatë, Policia e Kosovës ka thënë në një deklaratë se nuk ka përdorur gaz lotsjellës ndaj protestuesve. Sipas këtij institucioni, dyshohet që gazi është hedhur nga

protestuesit.

Protestuesit kanë brohoritur "UÇK, UÇK" dhe "Marre, marre". Veteranët e UÇK-së u larguan të hënën nga oborri i Kuvendit të Kosovës pasi dështoi, për shkak të mungesës së kuorumit, votimi i paraparë për projektligjin për pagën minimale. Kundër votimit ishin deputetët opozitarë.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se kërkesat e tyre janë injoruar nga institucionet e Kosovës. "Jemi injoruar nga institucionet e vendit dhe jemi detyruar që pakënaqësitë tona t'i shprehim në protestë".

Pas dështimit të votimit të projektligjit në Kuvend, Klinaku tha se "kjo sot ishte paralajmërim që herëve të tjera do t'i bllokojmë e nuk do t'i lëmë të hyjnë as brenda".

Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, e ka akuzuar

kryeministrin Albin Kurti se është duke tentuar ta kthejë Serbinë në Kosovë. Në një deklaram para gazetarëve, Jashari ka kërkuar që projektligji për pagën minimale të kthehet në pikën zero dhe të fillojë diskutimi me veteranët e UÇK-së. "E dimë që edhe me partinë në pushtet ka deputetë që kanë dhënë shumë për të ardhur këtu për lirinë e vendit. Kemi deputetë që janë të burgosur politikë dhe pjesë e luftës së lavdishme të UÇK-së. Nëse biem në nivelin e një kryeministri, i cili duhet të dalë para nesh dhe para çdo shtrese e kategorie dhe të tregojë se ku e ka problemimin me vlerat më kulmore të kombit shqiptar. Në të kundërtën, ata që bien pre e një kryeministri të tillë dhe votojnë një ligj të tillë, ku përjashtohet kategoria më e ndritur - veteranët e luftës, i bëhen krah një kryeministri që ne dyshojmë që ai bën përpjekje ta kthejë Serbinë në Kosovë", ka thënë Jashari.

KMDLNj: Veteranët e UÇK-së duhet të përfshihen në Ligjin për Paga

Këshilli për Mbrojtjen e të

Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka thënë se veteranët e UÇK-së duhet të përfshihen në Ligjin për Paga. "KMDLNj përkrah çdo protestë paqësore, si një ndër të drejtat elementare të njeriut dhe në këtë kontekst e përkrah edhe protestën e veteranëve të luftës e cila është imponuar për shkak të shpërfilljes së skajshme që ia bëjnë institucionet aktuale të Kosovës. KMDLNj vlerëson se kryesia e Kuvendit dhe vetë kryetari i Kuvendit është dashur ta pranojnë një grup përfaqësuesish të veteranëve të luftës, t'i dëgjojnë propozimet e tyre dhe ta shmangin konfrontimin e veteranëve të luftës me Policinë e Kosovës e që është krejtësisht e panevojshme. KMDLNj fton palët që të ulen dhe përmes bisedimeve të gjejnë një zgjidhje të pranueshme për të gjithë në mënyrë që të mënjanohet përshkallëzimi i situatës sikur që ndodhi sot", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj i ka ftuar institucionet e Kosovës të tregojnë më shumë respekt për veteranët e luftës dhe të mos i shpërfillin duke i diskriminuar përmes përjashtimit nga Ligji për Pagën Minimale. "Në të njëjtën mënyrë po sillen edhe me pensionistët kontributpagues të

periudhës para luftës së fundit ndaj të cilëve po bëhen shkelje flagrante të të drejtave të njeriut në kundërshtim me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. KMDLNj përkujton opinionin dhe politikëbërësit, se edhe paga minimale e propozuar nga Qeveria e Kosovës (264 euro) më shumë paraqet fyerje për veteranët e UÇK-së sesa që është një vlerësim e lëre më shpëgjim për kontributin e tyre gjatë luftës së fundit në Kosovë!", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Krasniqi: Pushteti i 'veteranit' të rrejshëm të Albin Kurtit sot tregoi fytyrën e vërtetë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti dhe deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me trajtimin e veteranëve në protestën e së hënës. "Pushteti i Vetëvendosjes, i udhëhequr nga 'veterani' i rrejshëm Albin Kurti, sot tregoi fytyrën e vërtetë me përbuzjen publike që ua bëri luftëtarëve të lirisë. Ngjarjet e sotme në

Kërkohet që çështja e Luginës së Preshevës të trajtohet në OKB

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës janë duke lobuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) që ta vendosin çështjen e komunave në jug të Serbisë, Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, në agjendën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Këtë e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", Ragmi Mustafi, kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar. Më herët, një medie lokale në Bujanoc, ka raportuar se përfaqësuesit e shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci janë takuar në Nju-Jork me ambasadorin e Shqipërisë në OKB, Ferit Hoxha, dhe pas këtij takimi është thënë se çështja e Luginës së Preshevës do të trajtohet në OKB.

Më 1 qershor për herë të parë Shqipëria ka marrë kryesimin njëmuor të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Kryetari i Kombëtar Shqiptar, Ragmi Mustafi, ka thënë se përfaqësuesit e komunitetit shqiptar që jetojnë në jug të

Serbisë janë duke kërkuar që në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë të zgjidhet problemi i Luginës së Preshevës.

"Ajo që kërkohet është që të mos ketë normalizim të marrëdhënieve derisa Lugina të jetë në agjendën e zgjidhjes së problemeve në Ballkanin Perëndimor. Kjo do të thotë se, përveç zgjidhjes së çështjes së pakicave kombëtare në Ballkanin Perëndimor, përmes normalizimit të marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit, duhet të ketë standarde uniforme për trajtimin e pakicave kombëtare", ka thënë ai.

Mediet në Bujanoc kanë raportuar se kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, kreu i Partisë për Veprim Demokratik, zyrtarja e kësaj partie, Ardita Sinani, dhe kryetari i Partisë Demokratike të Shqiptarëve, Ragmi Mustafa, kanë udhëtuar për në selinë e OKB-së që gjendet në Nju-Jork.

Pas takimit me ambasadorin



Hoxha të dielën, Arifi ka thënë se e kanë informuar ambasadorin shqiptar për "situatën politike në Luginë dhe problemet me të cilat ballafaqohen shqiptarët në Serbi".

Më 5 qershor Ardita Sinani ka publikuar në llogarinë e vet në

"Facebook" fotografi të delegacionit të përfaqësuesve politikë të shqiptarëve të Luginës në takimin me ambasadorin shqiptar në OKB, Ferit Hoxha, duke shtuar se "çështja e Luginës së Preshevës tashmë do të shtrohet në OKB".

"Përfshirja e Luginës së Preshevës në organizatën më gjithëpërfshirëse ndërkombëtare është tejet me rëndësi për ta shpërfaqur të vërtetën e gjendjes dhe pozitës së shqiptarëve të Luginës së Preshevës", ka thënë Sinani.



Kuvendin e Kosovës dhe trajtimi i padinjteshëm i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga pushteti i Albin Kurtit ishin pamje që asnjë qytetar i Kosovës nuk do të donte e as nuk do të duhej t'i përjetonte", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se kjo fyerje e ky diskriminim ndaj veteranëve të vërtetë, edhe përmes iniciativa ligjore, ku kryeministri i Kosovës i trajton luftëtarët e lirisë - kategorinë më meritore për lirinë tonë - si qytetarë të rendit

të dytë, është i papranueshëm dhe i pafalshëm. "Albin Kurti dhe shërbëtorët e tij të verbër duhet ta dinë që mbi guximin dhe sakrificën e këtyre veteranëve ne kemi ndërtuar shtet e institucione, në të cilat ata sot janë struktur e po orkestrojnë politika diskriminuese ndaj tyre. Partia Demokratike e Kosovës, si lidere e opozitës, me çdo mjet demokratik do t'i mbështesë të drejtat e veteranëve dhe nuk do ta lejojë përbuzjen e çlirimtarëve tanë në këtë mënyrë", ka deklaruar Krasniqi.

Kuvendi nuk voton për pagën minimale, shkak mungesa e kuorumit

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta kalojë në votim projektligjin që synon rritjen e pagës minimale. Për këtë pikë të rendit të ditës të hënën nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm.

Deputetët e opozitës, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)

dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), nuk kanë arritur t'i çojnë përpara mocionet për shtyrje të projektligjit dhe si përgjigje kanë lëshuar sallën duke pamundësuar votimin. Projektligji i miratuar në Qeverinë e Kosovës, që tani pret miratimin e Kuvendit,

parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto.

Momentalisht paga minimale në Kosovë është e ndarë në dy kategori: 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit mbi 35 vjeç.

Në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë kryhen mijëra shërbime mjekësore



GJAKOVË, 6 QERSHOR (ER) - Në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, gjatë periudhës janar - mars 2022, janë

ofruar mijëra shërbime mjekësore për pacientët me probleme të ndryshme shëndetësore. Gjatë kësaj kohe janë kryer

5 823 vizita ambulatore, 9 337 vizita diagnostike dhe 455 shërbime të tjera apo të veçanta. Sa iu përket shërbimeve laboratorike,

janë realizuar 24 560 analiza për 1 921 pacientë.

Shënohet Dita e Dëshmorëve të Mitrovicës

MITROVICË, 6 QERSHOR (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, dhe në bashkëpunim me Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, të hënën është mbajtur një manifestim kushtuar Ditës së Dëshmorëve të komunës së Mitrovicës. Me këtë rast, kryetari i komunës, Bedri Hamza, së bashku me nënkryetarin Arian Tahiri, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të institucioneve të tjera lokale, familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë, kanë bërë homazhe dhe kanë vendos buqeta me lule në varrezat e dëshmorëve në Shipol të Mitrovicës.

Fillimisht hapja e këtij organizimi është bërë nga përfaqësuesja e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Mitrovicë, Alije Tmava, e cila tha se 6 qershori, Dita e Dëshmorëve, është dita e krenarisë, në të cilën u sakrifkuan shumë të rinj që sot ne ta festojmë festën e pavarësisë. "Dëshmorët na bëjnë të jemi krenarë për vendin dhe kombin, por na bëjnë të jemi të përgjegjshëm me sjelljet



dhe veprimet tona ndaj kombit dhe shtetit tonë", ka thënë Tmava gjatë fjalimit të saj.

Kryetari Bedri Hamza tha se jemi mbledhur këtu që të shënojmë një ditë të veçantë, ditën e dhimbjes,

por edhe të krenarisë së madhe - 6 qershorin - Ditën e Dëshmorëve të Mitrovicës, ditën e heronjve tanë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Në këtë ditë, me respekt të thellë, i

kujtojmë dhe i nderojmë dëshmorët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë ditë, po ashtu, me respekt të thellë i kujtojmë dhe i nderojmë të gjithë dëshmorët e kombit, që ndër

breza bënë sakrificën e madhe që peri i jetës të mos këputet në këto troje. I përjetshëm qoftë kujtimi për ta! Lavdi për të gjithë dëshmorët!", është shprehur kryetari Hamza.

Komuna e Malishevës dhe Handikosi ndihmojnë rreth 300 familje në nevojë



MALISHEVË, 6 QERSHOR (ER) - Në kuadër të aktiviteteve të komunës së Malishevës dhe Qendrës së Rehabilitimit "Handikos" në Malishevë, ka filluar shpërndarja e pakove ushqimore për 300 familje në nevojë, kryesisht për anëtarët e Handikos në Malishevë. Shpërndarjen e këtyre ndihmave e kanë bërë nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi dhe koordinatoresha e kësaj qendre, Feride Hoxha.

Gjatë këtij aktiviteti nënkryetari Krasniqi ka thënë se janë duke jetuar në një kohë krize ekonomike dhe sociale, prandaj

aktivitetet e tilla, si kjo që ka bërë Handikosi në Malishevë, janë të mirëseardhura. "Ne do të përkujdesemi për të gjitha familjet në nevojë në komunën tonë dhe uroj të kemi sa më pak raste në nevojë, por mbështetja do të jetë e vazhdueshme", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa koordinatoresha e Qendrës së Rehabilitimit "Handikos" në Malishevë, Feride Hoxha, ka thënë se ky aktivitet është pjesë e programeve të tyre si organizatë dhe ky është vetëm një prej projekteve të tyre në shërbim të anëtarëve të "Handikos" në Malishevë.

Totaj fton diasporën për investime në Prizren

PRIZREN, 6 QERSHOR (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka marrë pjesë në Forumin e Bizneseve të Diasporës, në të cilin është diskutuar për investimet e diasporës në nivel komunal. "Në këtë

forum shpalosa planin e qeverisjes sonë duke theksuar se Prizreni është vendi i duhur për të bërë investime, prandaj i ftova bizneset e diasporës që të investojnë. Natyrisht, diaspora e Kosovës njihet për përkushtimin që ka dhe këtë e

tregon përmes remitancave, por do të ishte mirë që këto remitanca të drejtohen ndryshe në të ardhmen. Megjithatë, diaspora paraqet një kapital jo vetëm ekonomik, por edhe social dhe kulturor", ka thënë Totaj.



PDK-ja kërkon që paga minimale të bëhet 350 euro

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rashit Qalaj, në një konferencë për medie ka theksuar se projektligji për përcaktimin e pagës minimale është i papranueshëm për këtë parti politike, pasi është projektligj diskriminues. “Kërkojmë që lartësia e pagës minimale të ngritet në 350 euro, sepse shuma prej 250 eurosh nuk mjafton as për gjërat elementare të shumicës së kategorive të cilat do të futen në këtë pagë minimale”, ka thënë Qalaj



enorme të çmimeve, sidomos të produkteve bazë që prekin qytetarët e Kosovës”, ka deklaruar

Qalaj. PDK-ja konsideron se rritja e pagave dhe tërheqja e 30 për qind

të kursimeve nga Trusti janë zgjidhje për ta ndaluar varfërimin e qytetarëve.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 QERSHOR- Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rashit Qalaj, në një konferencë për medie mbajtur të hënën, ka thënë se projektligji për përcaktimin e pagës minimale është i papranueshëm për këtë parti politike pasi është projektligj diskriminues. Qalaj ka kërkuar që paga minimale të ngritet në 350 euro dhe të bëhet plotësimndryshimi i projektligjit për pagën minimale. “Kërkojmë që lartësia e pagës minimale të ngritet në 350 euro, sepse shuma prej 250 eurosh nuk mjafton as për gjërat elementare të shumicës së kategorive të cilat do të futen në këtë pagë minimale”, ka thënë Qalaj. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës ka bërë një propozim në

mënyrë arbitrare pa u konsultuar fare me Këshillin Ekonomiko-social, i cili, në bazë të Ligjit të Punës, duhet ta japë propozimin për pagën minimale në Kosovë. “Qeveria, duke u sjell në mënyrë arrogante, ka propozuar që paga minimale të jetë 250 euro, mirëpo ka përjashtuar shumë kategori të rëndësishme të vendit. Ju e dini që premtimet e kryeministrit të tashëm Albin Kurti gjatë fushatës zgjedhore kanë qenë që paga minimale të jetë 350 euro dhe me këtë ka bërë kampanjë kudo dhe ka marrë mbështetje të gjerë popullore. Ndërsa me anë të këtij projektligji propozon ngritjen e pagës minimale në 250 euro, pagë e cila nuk i plotëson as për së afërmi nevojat e qytetarëve të Kosovës, duke pasur parasysh që zhvillimet e fundit që kanë ndodhur në vend me ngritjen

Policia e Kosovës identifikon 18 viktimat të kontrabandimit të migrantëve



PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Policia e Kosovës ka ndaluar një autobus/minibus në të cilin ndodheshin tetëmbëdhjetë pasagjerë. Pas legjitimitetit të tyre është vërtetuar se të njëjtët janë shtetas të huaj. “Policia e Kosovës, konkretisht Njësia e Trafikut Rajonal - Prishtinë, gjatë zbatimit të detyrave të rregullta për identifikimin e kundërvajtësve dhe parregullsive të tjera në trafikun rrugor, ka ndaluar për kontroll rutinor një autobus/minibus të tipit

‘Mercedes’, me targa vendore, ku gjatë kontrollimit të tij janë identifikuar 18 tetëmbëdhjetë persona, prej tyre njëmbëdhjetë shtetas nga Siria, gjashtë shtetas nga Egjipti dhe një nga Iraku. Të njëjtët kanë potencuar se në mënyrë të organizuar dhe të udhëhequr nga disa persona, përmes rrugëve ilegale nga Turqia, dhe shtete të tjera, përfshirë edhe Kosovën, kishin për qëllim shkuarjen në drejtim të vendeve të BE-së”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Lidhur me rastin janë angazhuar zyrtarë policorë nga Sektori i Hetimeve në kuadër të Departamentit për Kufi të cilët janë marrë me procedurat e nevojshme për trajtimin e këtij rasti. Me urdhër të prokurorit kujdestar, i dyshuari mashkull, shtetas i Kosovës, është arrestuar dhe i njëjti është dërguar në mbajtje për 48 orë. Ndërsa shtetasit e huaj, pas intervistimit nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Prishtinë, janë dërguar në qendër të azilit.

Limaj: Komandant ‘Kapuçi’ e donte lirinë e Kosovës

KLINË, 6 QERSHOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, bashkë me kryetarin e komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së Nismës, të hënën kanë marrë pjesë në hapjen e edicionit të 20 të Festivalit Folklorik “I Këndojmë lirisë”, festival ky që mbahet në nderim të luftës heroike të Mujë Krasniqit - komandant “Kapuçi”, së bashku me luftëtarët dhe dëshmorët e

tjerë të lirisë. Në jubileun e 20 të këtij festivali, që nisi në vendlindjen e komandant Mujë Krasniqit në Çabiq, pikërisht më 6 qershor, që shënon edhe ditëlindjen e Mujës, një fjalë rasti mbajti edhe kryetari Limaj ku, mes të tjerash, tha se Mujë Krasniqi dhe Beqir Gashi, përveç që ishin luftëtarë të mëdhenj, ata me këngët e tyre ishin frymëzim për bashkëluftëtarë të tjerë.

Limaj ka thënë Mujë Krasniqi ishte një burrë që ngërthente në gjithë personalitetin e tij frymëzimin, artin, kulturën. Ai e donte jetën, traditën dhe lirinë e Kosovës. Ai i këndoi lirisë së Kosovës. Punoi dhe, në fund, luftoi dhe ra heroikisht për lirinë e Kosovës. “Shpresoj, e lutemi të gjithë bashkë që vitin e ardhshëm fjalën e hapjes të këtij festivali folklorik, para gjithë neve, ta mbajë gjeneral Rexhep Selimi”, ka thënë Limaj.



Kosova mund të ketë rritje të përshpejtuar ekonomike duke shtuar ritmin e reformave

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 QERSHOR- “Duke shtuar ritmin e reformave kyçe, Kosova mund ta përshpejtojë rritjen ekonomike dhe brenda njëzet vjetëve të ardhshme t’i arrijë standardet aktuale të jetesës së vendeve të Bashkimit Evropian si Letonia, Estonia, Lituania, Republika Çeke dhe Sllovenia”, thuhet në memorandum të ri ekonomik të Bankës Botërore për Kosovën, i paraqitur të hënën. Gjatë 25 vjetëve të fundit të hyrat për kokë banori në Kosovë janë rritur më shumë se 10 herë nga rreth 400 dollarë amerikanë në vitin 1995 në mbi 4 000 dollarë amerikanë në vitin 2022. Përkundër këtij përparimi, të hyrat për kokë ende janë vetëm sa 12 për qind e vlerës përkatëse në shtetin anëtar mesatar të BE-së, ose 20 për qind e vlerës në vendet e lartcekura që Kosova mund të aspirojë. “Me reformat e duhura Kosova mund të përgatitet për një të ardhme më produktive. Nëse shfrytëzohen në mënyrën e duhur dhe në kohën e duhur, përparësitë ekonomike të Kosovës mund të jenë katalizatorë për përshpejtimin e rritjes në mënyrë që të arrihen standarde më të larta jetese”, ka thënë

Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën.

Sipas raportit, përmes një pakete të reformave që ruajnë stabilitetin makroekonomik dhe qeverisjen e shëndoshë, sjellin rritjen e produktivitetit të ndërmarrjeve, rritjen e produktivitetit të fermave, rritjen e kapitalit njerëzor dhe nxitjen e eksporteve, konkurrencës dhe investimeve private (veçanërisht investimeve të huaja direkte), Kosova mund ta arrijë mbylljen e hendekut me shtetet e ngjashme [Evropiane]. “Një sektor privat më dinamik është thelbësor për arritjen e standardeve më të larta të jetesës në Kosovë, por vendi përballet me disa sfida. Mungesa e vendeve të punës është një pengesë e madhe për rritjen. Vetëm 2 në 5 persona në moshë pune janë aktualisht pjesë e tregut të punës dhe 1 në 4 persona nuk mund të gjejnë punë. Rritja e produktivitetit në biznes dhe në bujqësi është e ulët. Produktiviteti i punës është vetëm sa një e treta e një kompanie mesatare të BE-së, kurse ferma mesatare do të mund të ofronte të njëjtën sasi prodhimi duke përdorur 70 për qind më pak inpute. Biznesi dominohet nga ndërmarrjet e vogla që shpesh nuk ia dalin të



riten dhe të mbijetojnë. Veç kësaj, ende ka barriera ndaj fuqizimit ekonomik të grave. Vetëm 20 për qind e grave marrin pjesë aktive në tregun e punës, ndërkohë që edhe pjesëmarrja e grave në ekonomi si ndërmarrëse është e kufizuar. Me rritjen e shpenzimeve për arsim duhet të përmirësohet edhe cilësia e kapitalit njerëzor”, thekson raporti.

Kosova shpenzon 4.6 për qind

të BPV-së dhe 16 për qind të shpenzimeve totale të qeverisë për arsim, një përqindje e përafërt me atë të vendeve të ngjashme. Megjithatë, vetëm 23 për qind e fëmijëve parashkollorë janë në rrugën e duhur për sa iu përket shkathtësive të pritshme të shkollimit dhe numërimit. Raporti nënvizon se afërsia me tregjet madhore në Evropë dhe popullata e re në moshë ofrojnë një mundësi për rritje,

ndërkohë që po përmirësohen lehtësimi i tregtisë dhe lidhshmëria logjistike. “Afërsia me një treg të madh dhe të pasur, tatimet dhe kostot e ulëta të punës, sektori financiar i qëndrueshëm dhe likuid, si dhe lidhjet e forta me diasporën, mund ta ndihmojnë rritjen edhe më shumë”, ka thënë Richard Record, kryekonomist i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor.

ATK-ja mblodhi 35.6 milionë për periudhën janar - maj



PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Institucioni i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) ka vazhduar trendin e mbledhjes së të hyrave duke tejkaluar pritshmëritë edhe të muajit maj.

Krahas planit për periudhën janar-maj 2022 janë mbledhur 35.6 milionë euro apo 12.8 për qind më shumë se projekcioni. “Këtë ritëm të inkasimit sigurisht e ka mundësuar përkushtimi maksimal i menaxhmentit dhe stafit të ATK-së, duke realizuar shumë aktivitete të cilat kanë përmirësuar performancën e ATK së, duke u nisur nga inkasimi dhe trajtimi i borxheve, avancimi i

vazhdueshëm i shërbimeve ndaj tatimpaguesve dhe qytetarëve, si dhe shtimi i bashkëpunimeve me institucionet e vendit”, ka njoftuar ATK-ja.

Ky institucion ka njoftuar se të gjitha këto aktivitete, përveç tejkallimit, kanë dhënë rezultate edhe nëse krahasohet me periudhën e njëjtë 2021, ku ka rritje për 70.2 milionë euro apo 28.9 për qind, ku totali i inkasimit arrin vlerën e 312.7 milionë euro. “ATK-ja, po ashtu, falënderon të gjithë tatimpaguesit që me vetëdeklarim kanë arritur të kemi një përqindje të konsiderueshme të përmbushjes vullnetare”, ka njoftuar ATK-ja.

Javën e ardhshme shqyrtohet në Kuvend projektligji për tërheqjen e Trustit

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Shefja e grupit parlamentar nga Lëvizja Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se seanca e radhës e Kuvendit do të mbahet më 16 qershor. Kusari-Lila ka thënë se, përveç diskutimit për pikat e rendit të ditës, në diskutim do të vihet

edhe shqyrtimi i projektligjit për Fondet Pensionale të Trustit. “Seanca e re plenare e Kuvendit do të mbahet javën e ardhshme më 16 qershor. Me listën e pikave që kanë ardhur në kryesi, gjithashtu ato të cilat janë plotësim i agjendës, varësisht nga agjenda e komisioneve,

përveç pikave të rendit të ditës, në shqyrtim është edhe projektligji për plotësimin e ligjit për heqjen e akcizës së duhanit dhe shqyrtimi i parë i projektligjit për Fondet Pensionale të Kosovës”, ka thënë deputetja e LV-së.



Si mund ta parandalojmë pandeminë e ardhshme?



Nga Mark HONIGSBAUM

Vetëm nëse do jetonit në ndonjë shpellë, mund të mos e dinit se jemi në mesin e një rres prej pandemive më shkatërruese në histori. Sesa shkatërruese është, kjo u bë e qartë në fillim të këtij muaji kur Organizata Botërore e Shëndetësisë publikoi një raport që vlerësonte numrin e global të vdekjeve shtesë për shkak të pandemisë, 15 milionë, ose gati 3-fishi i numrit zyrtar të vdekjeve nga Covid-19.

Autoritete të tjera, mendojnë se vdekjet shtesë në nivel global mund të jenë afro 18 milionë. Këto janë shifra shumë të larta, por gjithsesi duken ende të vogla kur krahasohen me pandeminë e gripit spanjoll të viteve 1918-1919, e cila vrau rreth 40 milionë njerëz, ose ekuivalente me rreth 150 milionë në mbarë botën duke përdorur shifrat aktuale të popullsisë.

Por sado e fortë, kjo pandemi nuk është më e madhja që kemi parë. Bill Gejts thotë se një pandemi e tillë na pret në një të ardhme jo shumë të

largët, prandaj ai na këshillon të nisim që tani përgatitjet. “Është joshëse të supozohet se patogjeni tjetër i madh do të jetë po aq i transmetueshëm dhe vdekjeprurës sa Covid-19, dhe po aq i ndjeshëm ndaj inovacioneve siç janë vaksinat mRNA. Por sikur të mos jetë kështu?” - shkruan ai në librin e tij të ri.

Kjo është një pyetje e mirë. Në thelb Gejts thotë që ne duhet të bëjmë më shumë nga ajo që po bëjmë tashmë, por më mirë dhe më shpejt. Askush nuk mund të thotë nëse pandemia e ardhshme do të shkaktohet nga një koronavirus, grip, apo ndonjë patogjen që nuk e kemi marrë ende në konsideratë.

Por përmes sistemeve më të mira të mbikëqyrjes dhe diagnostikimeve laboratorike, ne duhet të jemi në gjendje të identifikojmë me shpejtësi faktorin, dhe të hartojmë kundërmasa mjekësore përpara se një shpërthim epidemik të ketë shansin të dalë jashtë kontrollit.

Gejts është akuzuar se i ka përdorur vaksinat për të futur mikroçipa në trupat e njerëzve pa dijeninë e tyre, dhe ai është një shënjestër e njohur e lëvizjes kundër vaksinave. Mbi

të gjitha, shkruan ai, ne duhet të “praktikohemi, praktikohemi dhe praktikohemi”, duke zhvilluar stërvitje të rregullta mbi situatat pandemike.

Në këtë kuadër, ai propozon krijimin e një ekipi prej 2000 personash që do të luajnë rolin e “zjarrfikësve pandemikë”. Gejts e etiketohen këtë grup si GERM (Reagimi dhe Mobilizimi Global ndaj Epidemisë). Akronimi në anglisht do të thotë edhe mikrob.

Por filantropi i njohur e pranon se masa të tilla nuk do të kenë vlerë nëse, pasi identifikojmë të metat në sistemet tona të reagimit ndaj pandemisë, nuk arrijmë që t'i korrigojmë ato. Për shembull në vitin 2016, stërvitja epidemioogjike “Cygnus” në Britani, identifikoi boshllëqe në gatishmërinë e Mbretërisë së Bashkuar në rastin e një pandemie të gripit, duke përfshirë rezerva të pamjaftueshme të ventilatorëve, por askush nuk veptoi sipas rekomandimeve.

Po ashtu, autoritetet shëndetësore në SHBA, e dinin prej kohësh se diagnostikimi në masë do të ishte vendimtar në rastin e një pandemie. Por

Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) dështuan të bëjnë teste në shkallën e kërkuar, duke penguar gjurmimin e kontakteve dhe masat efektive të izolimit.

Dhe për shkak të sistemit federal të qeverisjes së Amerikës, guvernatorët e shteteve shpeshherë nuk ishin të sigurt se kush ishte përgjegjës për çfarë. Rezultati: SHBA-ja pësoi një nga nivelet më të larta të vdekshmërisë nga Covid-19 në botë.

Ndërkohë, vende si si Singapori, Vietnami dhe Kanadaja, të cilat ishin goditur keq nga SARS-i në vitin 2003 dhe i kishin përvetësuar leksionet, reaguan shpejt dhe me vendosmëri ndaj Sars-CoV-2, siç njihet koronavirusi që shkakton sëmundjen e Covid-19.

Por nëse parandalimi i pandemive do të ishte thjesht një çështje e logistikës më të mirë dhe e besimit tek ekspertët, me siguri që do ta kishim zgjidhur problemin. Dhe fakti që nuk e kemi bërë, ka të bëjë me faktin se shkenca është plot me pasiguri, sidomos në fazat e hershme të

një pandemie, kur mund të mungojnë të dhënat e besueshme mbi infektivitetin e një patogjeni dhe mënyrën e përhapjes së tij.

Për shembull në vitin 2014, pak ekspertë mendonin se Ebola, një virus që më herët kishte shkaktuar shpërthime epidemike në të gjithë Afrikën Qendrore, përbënte një kërcënim për vendet në Afrikën perëndimore si Sierra Leone dhe Liberia.

Po ashtu, bazuar në përvojën e SARS-it, e cila ishte e lehtë për t'u dalluar, sepse të infektuarit u sëmurën me shpejtësi dhe me shenja të dukshme, pak ekspertë menduan se Sars-CoV-2 do të ishte në gjendje të përhapej nga asimptomatikët. Kur e kuptuan, ishte tepër vonë. Pra parandalimi i pandemive është po aq një problem epistemologjik sa edhe teknik. Ne mund të përgatitemi për kërcënimet e njohura pandemike, por të ashtuquajturat ngjarje kataklizmike janë të panjohura dhe të paparashikueshme.

Shënim: Mark Honigsbaum, është autor i librit “Shekulli pandemik: Nga Gripi Spanjoll tek Covid-19”.

“The Guardian” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Selmani: Po largohem me kokën lart nga Llapi

Kastriot Selmani në edicionin e ri 2022/23 nuk do të jetë pjesë e skuadrës së Llapit, pasi nuk ka gjetur gjuhë të përbashkët me drejtuesit e klubit për vazhdimin e kontratës. “Po largohem nga Llapi ballëhapur sepse përgjatë këtyre tre vjetëve nuk kurseva asgjë për klubin dhe falë mbështetjes nga klubi dhe bashkëlojtarët arritëm t’ia sjellim Podujevës tre trofe, dy Kupa të Kosovës dhe një Superkupë”, ka thënë Selmani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Futbollisti Kastriot Selmani edhe zyrtarisht është ndarë me skuadrën e Llapit, pasi nuk ka gjetur gjuhën e përbashkët për ta vazhduar kontratën. Selmani ishte pjesë e Llapit në tre vjetët e fundit ku arriti të fitojë dy kupa dhe një superkupë. Ai ka thënë se nga Llapi po largohet kokëlartë për faktin se nuk ka kursyer asgjë dhe sukseset nuk kanë munguar. “Ju njoftoj që pasi nuk gjetëm gjuhën e përbashkët për ta vazhduar bashkëpunimin, mora një vendim jo të lehtë për mua që pas tre vjetëve të largohem nga skuadra e vendlindjes, KF Llapi. Dua ta falënderoj kryesinë e klubit për korrektësinë, në veçanti presidentin Beqir Batatina, shtabin teknik në krye me trajnerin Tahir Batatina për mbështetjen dhe besimin e ofruar gjatë këtyre viteve, stafin e klubit dhe bashkëlojtarët për të gjitha çastet e bukura që kaluam së bashku. Një falënderim të veçantë për tifozët ‘Legjendat’ dhe çdo qytetar llapjan për mbështetjen ndaj meje edhe kur nuk isha në ditët më të mira. Po largohem nga Llapi ballëhapur sepse përgjatë këtyre tre vjetëve nuk kurseva asgjë për klubin dhe falë mbështetjes nga klubi dhe bashkëlojtarët arritëm t’ia sjellim Podujevës tri trofe, dy kupa të Kosovës dhe një superkupë”, ka thënë Selmani, i cili Llapit i ka uruar suksese edhe në garat evropiane dhe në edicionin e ri. “Për mua kjo



nuk është një lamtumirë, por një mirupafshim”, ka shtuar Selmani. Fituesja e Kupës, pas një pushimi dhjetëditor, i rikthehet punës për ndeshjet e raundit të parë kualifikues të

UEFA “Conference League” të cilat nisin nga data 7 korrik. Kundërshtarit për rrethin e parë skuadra e Llapit e mëson më 14 qershor në shortin që do të hidhet në Nyon të Zvicrës.

SHKURT

Ferizaj ‘blindon’ Shabanin dhe Çerkinin

Skuadra e Ferizajt ka njoftuar se ka vazhduar bashkëpunimin me dy futbollistët e njohur Egzon Shabani dhe Dardan Çerkini. Lajmin e ka bërë me dije klubi ferizajas përmes një njoftimi në faqen zyrtare në rrjetet sociale. “Klubi ynë, pas negociatave me dy lojtarët, ata kanë pranuar ofertën që klubi ua ka ofruar dhe kemi vazhduar bashkëpunimin edhe për një sezon me mbrojtësin Dardan Çerkini dhe me mesfushorin Egzon Shabani”, thuhet në njoftimin zyrtar të Ferizajt.

Fatona Kasapi, e pesta në Kupën Evropiane U21

Fatona Kasapi, xhudiste e kategorisë -57 kilogramë, është renditur e 5-ta në Kupën Evropiane U21 që është mbajtur në Graz të Austrisë. Kasapi në xhiron e parë ishte e lirë, në xhiron e dytë mposhti me Ippon gjeorgjianen Nino Loladze. Në raundin e tretë ajo mposhti me Ippon gjermanen Shenna Nitsche, në çerekfinale mposhti me Ippon holandezen Elin Henninger, ndërsa në gjysmëfinale humbi me Ippon nga zvicerania Binta Ndiaye. Pas asaj humbjeje ajo u kualifikua në ndeshje për medalje të bronzte, ku prapë humbi me Ippon në vazhdim nga garuesja e Kazakistanit, Shukurjon Aminova, dhe kështu u rendit e 5-ta në këtë kupë evropiane.

Rrahmani ‘harron’ humbjen nga Greqia: Duhet të fitojmë ndaj Irlandës

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, u shfaq i qetë pas humbjes me Greqinë. Mbrojtësi deklaroi se skuadra dha maksimumin, por nuk arriti t’i shfrytëzojë rastet e krijuara. “Pas Qipros fola për presingun lart, që nuk e përballojmë si duhet dhe qëndruam në bllok, duke i pritur kundërshtarët në mes. Kur e kemi fituar topin, kemi qenë më të rezikshëm, por nuk kemi shfrytëzuar rastet tona. Duhet të konsolidohemi sa më shpejt për të shkuar në të dyja ndeshjet e radhës për të fituar, duke filluar nga ajo me Irlandën e Veriut. Do të kemi dy mungesa të tjera, por nuk është justifikim, ndaj duhet të punojmë që të kthehemi te fitorja. Na kishte munguar një atmosferë si kjo në stadiumin tonë. Jam krenar edhe për atë që dhamë”, ka thënë Rrahmani.

Xhaka: Ndaj Portugalisë e humbëm ndeshjen për pesë minuta

Zvicra pësoi humbje nga Portugalia (4-0). Pas kësaj humbjeje ka reaguar kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, duke thënë se e humbën takimin brenda pesë minutave. “Kemi filluar mirë dhe më pas humbëm ndeshjen për pesë minuta. Si ekip mysafir, kemi lejuar që të luhet me kundërsulme ndaj nesh. Kjo nuk është dashur të ndodhë”, ka thënë Xhaka. “Kemi qenë me fat në pjesën e parë që Portugalia nuk ka shënuar dy apo tre gola më shumë”, ka shtuar Xhaka. Zvicra në ndeshjen e radhës e pret Spanjën në “Stade de Geneve”.

Galatasaray rikthen interesimin për Muriqin

Istanbul, 6 qershor - Ende nuk dihet se në cilën skuadër do të luajë në sezonin e ardhshëm sulmuesi Vedat Muriqi. Sulmuesi “dardan” shkëlqeu në La Liga për gjysmësezonin sa luajti në Mallorca duke i realizuar pesë gola dhe duke i bërë tri asistime. Por, klubi spanjoll nuk ka vendosur ende nëse do ta blejë apo jo

kartonin e prizrenasit, i cili u huazua për 6 muaj në ishull. Interesimin për Muriqin e ka rikthyer skuadra turke Galatasaray. Portali “Fotomac” shkruan se ish-futbollisti i Giresunsporit, Gençlerbirliğit, Rizesporit dhe Fenerbahçes dëshiron ta kuptojë sa më shpejt të ardhmen e tij, respektivisht menjëherë pas

angazhimeve që i ka me Përfaqësuesen e Kosovës. Kartonin e sulmuesit e ka Lazio, e cila, megjithatë, nuk e ka ndër mend ta mbajë atë në ekip pasi dështoi në përvojën e tij prej një viti e gjysmë në kryeqytetin italian. Muriqi vlerësohej më parë 12 milionë euro, ndërsa Lazio është e gatshme ta shesë atë për 10 milionë.



Presidenti i Bayernit: Lewandowski edhe në sezonin e ardhshëm do të luajë me ne

MUNCHEN, 6 QERSHOR - Presidenti i Bayern Munchenit, Herbert Hainer, ka folur për çështjen e lidhur me Robert Lewandowskin. Sulmuesi polak po dëshiron në të gjitha mënyrat të largohet nga gjiganti bavarez,

një mënyrë që nuk është pëlqyer aspak nga drejtuesit e klubit. Ish-futbollisti i Borussia Dortmundit ka kontratë me klubin nga "Allianz Arena" deri në vitin 2023, por ëndërr e tij është të përfundojë qysh këtë verë në

Barcelonë. "Një kontratë është një kontratë. Ku do të përfundojmë nëse një lojtar mund ta shkëputë kontratën para kohe, ndërsa ne të klubit duhet ta paguajmë deri në ditën e fundit? Më ka befasuar që

Roberti ka folur në atë mënyrë, unë nuk do ta bëj. Mirëpo, nuk jam i brengosur. Ai është një profesionist dhe jam i bindur se do të luajë me ne në sezonin e ardhshëm", u shpreh Hainer për tabloidin gjerman "Bild".



Skenat e dhunshme para finales në Ligën e Kampionëve vënë në rrezik Olimpiadën e Parisit

PARIS, 6 QERSHOR - Trazirat që ndodhën pak ditë më parë në Paris, jashtë stadiumit në finalen e Ligës së Kampionëve, kanë hedhur pikëpyetje të mëdha në lidhje me organizimin në kryeqytetin francez të Lojërave Olimpikë "Paris 2024". Natyrisht që pikëpyetjet kanë lidhje me sigurinë e këtij eventi olimpik. Në këtë stadium do të organizohen garat e atletikës dhe ragbitë me 7 lojtarë në Olimpiadë. Ndërkohë që, objektivi i organizatorëve është që ceremonia e hapjes të organizohet në ambient jashtë stadiumit. Por trazirat që ndodhën aty para finales së futbollit tregojnë se mund të ketë trazira edhe gjatë Olimpiadës. "Ne po marrim masa që ajo skenë që ndodhi në Paris para finales në mes të Real Madridit dhe Liverpoolit të mos përsëritet në të ardhmen aq më shumë në një Olimpiadë. Nuk dëshirojmë që një event kaq madhor si Olimpiada të



shëmtohet nga skena dhune", thanë organizatorët e Lojërave Olimpikë. "Ne do të vijojmë me projektin tonë, që ta zhvillojmë ceremoninë e hapjes përgjatë lumit Sena. Kjo kërkon shumë

rregull e forca policie, që gjithçka të shkojë mbarë, pa trazira e polemika. Urojmë që skena si ato të mos i shohim përgjatë Olimpiadës sonë", kanë shtuar organizatorët e "Paris 2024".

Golden State mposhti Bostonin dhe barazoi serinë e finaleve

SAN FRANCISCO, 6 QERSHOR - Skuadra e Golden State Warriorsit fitoi me rezultat 107-88 ndaj Boston Celticsit në ndeshjen e dytë finale "play-off" në NBA, duke barazuar 1-1 serinë e takimeve mes tyre. Për dallim nga sfida e parë, fituar nga Celticsi në periodën e fundit, këtë herë në fushë komanduan vendasit, që nuk toleruan dhe përsëritën gabimet e takimit të parë. Stephen Curry me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë për skuadrën e Golden States, ndërkohë që këtë herë edhe stoli i Warriorsit ishte vendimtar, me 35 pikë. Për Bostonin u dallua Tatum me 28 pikë, por ishte i vetëm në këtë betejë, pa mundur dot të rivalizojë. Dy ndeshjet e radhës do të luhen në fushën e skuadrës së Bostonit.



Quartararo: Nuk kam pilotuar kurrë më mirë se tani në karrierën time

Kampioni i botës në fuqi në MotoGP, francezi i Yamahas, Fabio Quartararo, nuk e kishte imagjinuar se do të fitonte në garën e Katalunjës në atë mënyrë, duke përfutur nga gabimi i Aleix Espargaro. Spanjollit

mendoi se e fitoi garën, por harroi se kishte ende edhe një xhiro për të kompletuar, duke ia bërë më të lehtë fitoren Quartararos. Pavarësisht kësaj, francezi i Yamahas shprehet se po kalon një moment të mirë,

duke fituar dy gara këtë sezon dhe duke qenë pesë herë në podium. Ai ka qenë gjithnjë konstant. "Ndihej sikur nuk kam pilotuar kurrë më parë si në këtë mënyrë. Mendoj se ky është momenti më i mirë i

karrierës sime në MotoGP", ka thënë Quartararo. Francezi ka 22 pikë avantazh ndaj rivalëve në renditje, duke ndërthurur ashtu si vjet shkallë pas shkallë triumfin përfundimtar. "Kam besim

total te ky motor. Ndiej se po jap më të mirën me këtë motor dhe ndihem komod duke e pilotuar. Madje ndiej se kam ende për t'i marrë motorit 2 apo 3 të dhjetat më shumë në pistë", ka shtuar Quartararo.

SHKURT

Dortmundi e dëshiron Brojën në vend të Haalandit

Armando Broja është lidhur me një transferim në Serinë A, pasi Napoli e sheh si zëvendësues ideal të Viktor Osimhenit, por në garë për sulmuesin shqiptar ka hyrë edhe Borussia Dortmundi. Sipas "Sky Gjerman", Dortmundi e sheh Brojën si zëvendësues për Erling Haaland. Chelsea kërkon 58 milionë paund për ta lënë të lirë Brojën, shifër kjo e cila konsiderohet e lartë nga të dy klubet. Në garë për sulmuesin është edhe Arsenalit.

Liverpooli e refuzon ofertën e Bayernit për Manen

Skuadra e Liverpoolit e ka refuzuar ofertën e parë të Bayern Munchenit për Sadio Mane. Ylli i "Reds"-it pritet të largohet edhe pse ka kontratë edhe për një vit me Liverpoolin. Oferta e klubit gjerman është 21 milionë funte për lojtarin por, sipas "The Times", Liverpooli e ka refuzuar. 30-vjeçari është pjesë e Liverpoolit nga viti 2016 ku me këtë klub ka regjistruar 196 paraqitje dhe ka shënuar 90 gola.

Pensionohet Bruno Alves

Mbrojtësi i njohur portugez, Bruno Alves, i cili është shpallur edhe kampion i Evropës me Portugalinë në "Euro 2016", e ka komunikuar këtë lajm me anë të një postimi në profilin e tij të rrjetit social "Instagram" duke shkruar se ky rrugëtim përfundon këtu. "Ju komunikoj fundin e karrierës sime futbollistike, duke falënderuar për gjithçka, të gjitha klubet, drejtuesit, trajnerët dhe njerëzit që janë përfshirë në jetën time sportive. Faleminderit familjes dhe miqve të mi për të gjithë mbështetjen në çdo kohë. Udhëtim që përfundon, por do të shfaqen mundësi të tjera. Shihemi së shpejti. Faleminderit", ishte postimi i 40-vjeçarit.

Portugezi e mbylli karrierën në Superligën e Greqisë me fanellën e Apollon Smirnis ku u aktivizua gjithsej në kampionat në 19 ndeshje. Alvesi ka mbajtur veshur edhe fanellat e Portos, Vitoria Guimaraes, AEK-ut të Athinës, Zenitit, Fenerbahçes, Calgarit, Rangersit, Parmës dhe Famalikaos.

Pogba rikthehet te Juventusit, mungon vetëm zyrtarizimi

Tashmë mungon vetëm zyrtarizimi për rikthimin e Paul Pogbas me fanellën e Juventusit. Sipas asaj që raportojnë mediet ishullore, gjithçka është e kryer dhe mungon vetëm firma në kontratë që gjithçka të finalizohet me sukses. Ajo që pritet është një takim që do të ndodhë ditë në vazhdim ku do të sistemohen edhe detajet e vogla. Pogba do të përfitojë kështu një pagë prej 7.5-8 milionë eurosh në sezon nga ana tjetër. Kontrata e tij do të jetë trevjeçare. Në kontratë përfshihet edhe mundësia për ta zgatur marrëveshjen edhe për një vit tjetër në rast se arrihen disa objektiva. Gjithmonë sipas medieve italiane, rikthimi i tij është vetëm çështje ditësh. Juventusit ka mposhtur kështu konkurrencën e Real Madridit dhe PSG-së për Paul Pogban.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për Tatimpagues

Mbjaj dokumentacionin sipas Ligjit!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjitha veprimtaritë ekonomike se janë të obliguara të mbajnë librat dhe regjistrimet konform legjislacionit tatimor.

Veprimtaritë ekonomike, të cilat krijojnë dhe mbajnë dokumentacione jo në rregull, si: shitje pa destinim-personave fizikë, blerjet nga personat fizikë, mos-dokumentimi dhe dokumentimi fiktiv, malli pa prejardhje-origjinë, fryrja e shpenzimeve, lëshimi i kuponëve fiskal nga distributorët, nënvlerësimi i çmimeve nga importi, mos-lëshimi i kuponëve fiskal, mbajtja e stoqeve dhe saktësia e tyre, dokumentimet tjera jo-reale, kreditimi dhe humbja e vazhdueshme, do të jenë në fokusin e ATK-së, derisa të arrihen objektivat për krijimin e një klime të volitshme për të gjitha bizneset.

ATK, vlerëson se numri i tatimpaguesve, të cilët krijojnë dhe mbajnë dokumentacionin jo në rregull është i konsiderueshëm, i cili shkakton efekte negative në aktivitetet biznesore, krijon klimë jo konkurruese dhe jo lojale për vet operimin e biznesit dhe njëkohësisht krijon humbje për buxhetin e Kosovës.

Në identifikimin e rasteve të tilla, ATK, në bazë të kompetencave është e autorizuar që të ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të verifikimit të librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesve dhe përcaktimit të drejtë të detyrimeve tatimore.

Vetëm tatimpaguesit, të cilët vullnetarisht mbajnë dhe prezantojnë librat dhe regjistrimet në harmoni me legjislacionin tatimor, nuk do të bëhen objekt ndëshkimi nga ana e ATK-së.

Tatimpaguesit të cilët nuk kanë përmbushur vullnetarisht detyrimin e tyre - mbajtjen dhe prezantimin e librave dhe regjistrimeve, i ftojme që vullnetarisht të bëjnë korrigjimet e nevojshme për të reflektuar gjendje reale mbi afarizmin e tyre, sepse në këtë mënyrë Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ju ofron lehtësira për tatimin shtesë të pa deklaruar me kohë.

Synimi ynë i vetëm është ngritja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, andaj ju inkurajojmë që të përmbushni detyrimet tuaja tatimore, në mënyrë që të mos bëheni objekt i ndëshkimeve.

Administrata Tatimore e Kosovës



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 06.06.2022 të shpallë:

KONKURS Për plotësimin e vendit të punës:

Koordinator transporti në Njësinë Punuese në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Udhëheqë dhe mbikqyrë punën e kontrollës interne në aspektin e përcjelljes së ecurisë të procesit të punës në Kompani duke evidentuar dhe denoncuar çdo keqpërdorim apo parregullësi eventuale që dëmton interesin dhe imigjin e Kompanisë nga shërbimi kompetent;
- Nga shërbimet kompetente në Kompani kërkon të merr evidencë për çdo kontratë të lidhur për shërbimet me personat e tretë dhe e përcjellë zbatueshmërinë e tyre në aspektin e kryerjes së shërbimeve dhe faturim korrekt;
- Ndërmerr veprime të opinionit të klientëve të shërbimit me kontratë rreth kualitetit të shërbimit, sjelljes së personelit të kompanisë dhe ndërmerr veprimet e nevojshme të parregullësive apo vërejtjeve eventuale;
- Angazhon ekipin e kontrollës interne në testimin e automjeteve për caktimin e normës reale mbi hargjimin e karburanteve dhe në këtë drejtim paraqet raporte me shkrim për çdo automjet të testuar, nga menaxherët e zonave, merr planin operativ të punës lidhur me zonat e veprimt të çdo vozitësi dhe në bazë të tij udhëzon ekipin e kontrollës për përcjellje të procesit të punës;
- Përcjellë zbatimin e aplikimin e rregullave per topografet, nga shoferët e kamionave nga dispeqeri dhe nga shefi i mirëmbajtjes dhe lidhur me të ndërmerr veprime për denoncim me rast të parregullësive eventuale, nga shërbimi i autoparkut për çdo muaj;
- Merr dhe i përpunon shenimet, të dhënat për kilometrazhë, orët e punës ngarkesat dhe tonazhat e mbeturinave për çdo kamion;
- Kryen edhe të gjitha punët tjera të kësaj natyre dhe punë tjera që i cakton udhëheqësi i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë Diplomë Universitare;
- CV-në
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jet në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj.mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 06.06.2022 deri më datën 21.06.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fortesa Zenelaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi".
- Margita Spaqi nga Fshaj KK. Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. "At Gjergj Fishta" Bishtazhi nga kl I-V dhe VI-IX.
- Leoart Haxhija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X,XI,XII të SH.M.T. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Baki Krasniqi shpall të humbur diplomën e shkollës së mesme "Ismail Dumoshi" Obiliq.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FTESË PËR OFERTË FURNIZIM

Konform udhëzuesit të brendshëm për prokurim Nr. 1/2009, për Autoritetet e Likuidimit

Data: 07.06.2022
Nr. i Prokurimit: AL-GH-0002

I: AUTORITETI KONTRAKTUES: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit të Ndërmarrjes së Re "Grand Hotel" SH.P.K

NENI II: QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me set të çarçafëve, këllëf jastëku dhe peshqirë

II.2 Lloji i kontratës dhe lokacioni i dorëzimit:

Furnizim me set të çarçafëve, këllëf jastëku dhe peshqirë për Ndërmarrjen e Re "Grand Hotel" SH.P.K, në Prishtinë, dërgimi i furnizimeve është: Objekti i Grand Hotel, Sheshi "Zahir Pajaziti" p/n, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

NENI III: KËRKESAT të cilat duhet të përmbushën nga OPERATORËT EKONOMIK

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

IV.2 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët

IV.2 Afati kohor për pranimin e tenderëve: më së voni më 20/06/2022 koha: 14:00.

IV.3 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 20.06.2022 **Koha:** 14:30:00 **Vendi:** Objektin e AKP-së, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë

- Tenderuesit fitues dhe apo/eliminues do të njoftohen përmes emailit
- Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të vulosura. Shikoni me kujdes kushtet të cilat duhet ti plotësoni.

Kërkesa për dosjen e tenderit: Dosja e tenderit mund të kërkohet me shkrim nga operatorët ekonomik në autoritetin kontraktues me e-mail në këtë adresë: granit.spahiu@pak-ks.org deri më 17.06.2022 apo të shkarkohet në webfaqen www.pak-ks.org.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

POZIV ZA PONUDU SNABDEVANJA

Prema internom vodiču za nabavku br. 1/2009, za organe za likvidaciju

Datum: 07.06.2022
Nr. i Prokurimit: AL-GH-0002

I: UGOVORNI ORGAN: Kosovska agencija za privatizaciju, Organ za likvidaciju Novog Preduzeća "Grand Hotel" DOO

ČLAN II: SVRHA UGOVORA

II.1 Naziv ugovora koji je dodelio ugovorni autoritet: Snabdevanje sa kompletom čaršava, jastucima i peškirimima

II.2 Vrsta ugovora i lokacija isporuke:

Snabdevanje sa kompletom čaršava, jastucima i peškirimima za Novo Preduzeće „Grand Hotel“ DOO, u Prištini, isporuka snabdevanja je: Objekat Grand Hotela, Trg „Zahir Pajaziti“ p/n, 10.000 Priština, Republika Kosovo

ČLAN III: ZAHTEVI koje moraju da ispune EKONOMSKI OPERATORI

IV.1 VREMENSKO OGRANIČENJE ZA DODATNE ZAHTEVE ILI OBJAŠNJENJA

IV.2 KRITERIJUMI ZA DODELU UGOVORA

Odogovarajuća ponuda sa najnižom cenom

IV.2 Vremenski rok za prijem tendera: najkasnije 20.06.2022. vreme: 14:00.

IV.3 Sastanak za otvaranje tendera:

Datum: 20.06.2022 **Vreme:** 14:30:00 **Mesto:** Zgrada KAP-a, Ul. "Dritan Hoxha" br.55, Ljakrašte, 10.000 Prishtina

- Pobednički i/ili eliminisani ponuđači biće obavesteni putem e-pošte
- Ponude moraju biti u zatvorenim i zatvorenim kovertama. Pažljivo pogledajte uslove koje morate ispuniti.

Zahtev za tenderski dosije: Tenderski dosije može da se zatraži od strane ekonomskih operatera u pisanoj formi od ugovornog autoriteta putem elektronske pošte na ovu adresu: granit.spahiu@pak-ks.org do 17.06.2022 ili preuzimanje na www.pak-ks.org.

